



Nr. Ref. BD-211/51

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P. Nr.09047-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 7598 m², ZK Prizren, pronë e NSh KBI Progres, Prizren, me parashtruesin nga Prizreni.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e KBI Progres, Prizren, me parashtruesin nga Prizreni.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës se tij kjo ngastër kadastrale qysh ka viti 1956 është në shfrytëzim faktik të paraardhësve të parashtruesit të kërkesës së bashku me anëtarët e familjes së tij dhe të njëjtit edhe sot janë mbajtës të kësaj patundëshmërie të cilën e kanë në shfrytëzim si tokë bujqësore dhe atë konform kontratës interne për shitblerje nga babi i nga fshati Lubinje e Epërme KK Prizren, e cila i mungon parashtruesit të kërkesës për shkak të luftës në Kosovë.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike dhe të cilat janë marrë nga ZKK në Prizren parcela 9047-0 ZK Prizren evidentohet si parcelë tokësore e klasit të pare dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit ka ndërtim, dhe po ashtu të njëjta kanë qasje të pa penguar në rrugë.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/52

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: P. Nr.05662-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 18938 m² dhe të sipërfaqes prej 1843 m² nga ngastra kadastrale P. Nr.05692-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 18878 m², ZK Jashtë Qytet. Prona të NSh KBI Ereniku, Gjakovë, me parashtruesin nga fshati Radostë, Rahovec.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Ereniku, Gjakovë, me parashtruesin nga fshati Radostë, Rahovec.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij parcelat të cilat janë objekt i kërkesës dëshiron ti blej përmes shitjes direkte pasi që të njëjtat i shfrytëzon që nga viti 1994 dhe të njëjta i përdorë për nevoja të familjes të destinuara kryesisht në aspektin bujqësorë. Tutje, pala thekson se i ka përmbushur deri më tani të gjitha obligimet sa i përket qiramarrjes nga Kompanisë në fjalë. Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike parcelat në fjalë evidentohet si parcelë bujqësore e klasit të tretë në vendin e quajtur Raqa. Parcelat kadastrale të cilat janë objekt i kërkesës gjendet në zonën kadastrale Jashtë Qytet në Komunën e Gjakovës dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këto parcela aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe të njëjtat do të kenë qasje të pa penguar në rrugë.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/53

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale: P. Nr.05691-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 18439 m² dhe P.Nr.05692-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4923 m², ZK Jashtë Qytet. Prona të NSH KBI Ereniku, Gjakovë, me parashtruesin nga Fshati Gexhë, Rahovec.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSH KBI Ereniku, Gjakovë, me parashtruesin nga Fshati Gexhë, Rahovec.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës se tij parcelat të cilat janë objekt i kërkesës dëshiron ti blej përmes shitjes direkte pasi që të njëjtat i shfrytëzon për më shumë se 10 vite.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike parcelat në fjalë evidentohet si parcelë bujqësore e klasit të tretë në vendin e quajtur Raqa. Parcelat kadastrale të cilat janë objekt i kërkesës gjendet në zonën kadastrale Jashtë Qytet në Komunën e Gjakovës dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këto parcela aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe të njëjtat do të kenë qasje të pa penguar në rrugë.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/54

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P. Nr.02436-2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 5402 m². ZK Demjan, pronë e NSh Kooperativa Bujqësore Demjan, Gjakovë, me parashtruesin nga fshati Demjan Gjakovë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KB Demjan, Gjakovë, me parashtruesin nga fshati Demjan Gjakovë.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës se tij kërkon ta blejë këtë parcelë përmes shitjes direkte mos jap detaj tjera po ndonjë arsyetim tjetër për ta mbështetur kërkesën e tij.

Në mbështetje të kërkesës pala ka prezantuar edhe ekspertizën gjeodezike duke treguar matjet lidhur me pretendimet e tij. Në këtë parcelë ka qenë i ndërtuar një objekt P+1 (i NSH-se) i cili aktualisht është pjesërisht i rrënuar me një sipërfaqe prej 321m².


Parcela kadastrale e cila është objekt i kërkesës gjendet në zonën kadastrale në Demjan në Komunën e Gjakovës dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit ka një objekt i cili është i rrënuar dhe i njëjti ka qenë objekt i NSH-se dhe e njëjta ka qasje të pa penguar në rrugë publike.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/55

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të 2000 m² nga ngastra P. Nr.00148-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 50847 m², ZK Carallukë, pronë e NSH KB Agroprogres, Malishevë, me parashtruesin _____, nga fshati Carallukë Malishevë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSH KB Agroprogres, Malishevë, me parashtruesin nga fshati Carallukë Malishevë.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës se tij parcela 148-0 gjendet përballë parcelave të tij private 497-0 dhe 498-0, dhe se në pamundësi që ti shfrytëzojë parcelat për shkak të sipërfaqeve të tyre, e njëjta sipas palës është shumë e nevojshme për të si shfrytëzues i saj. Tutje, i njëjti deklaron se këtë parcelë e ka në shfrytëzim që nga viti 2019 andaj të njëjtën dëshiron ta privatizoj përmes shitjes direkte. Në mbështetje të kërkesës pala ka prezantuar edhe ekspertizën gjeodezike duke treguar matjet lidhur me pretendimet e tij.


Parcela kadastrale e cila është objekt i kërkesës gjendet në zonën kadastrale në Carallukë në Komunën e Malishevës dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe të njëjtat do të kenë qasje të pa penguar në rrugë publike.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/56

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P. Nr.02897-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1852 m², ZK Mitrovicë, pronë e NSh Miniera "Kosova Azbest" Mitrovicë, me parashtruesin me pronar
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Miniera "Kosova Azbest" Mitrovicë, me parashtruesin me pronar

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës se tij parcelën dëshiron ta përmes shitjes direkte, pasi që në të njëjtën ushtron aktivitetin e tij afarist qysh nga viti 2000 dhe deri me tani nuk ka pasur mosmarrëveshje me fqinjët për kufijtë që i shfrytëzojnë. Pala paguan edhe qira mujore lidhur me shfrytëzimin e tij.

Pala e ka në shfrytëzim faktik nga viti 1999, parcelën Nr. 02897-1, me sipërfaqe të përgjithshme 1852 m², e cila evidentohet ne emër të NSH "Kosova Azbest" me seli në Mitrovicë. Në parcelën e cituar si më sipër, parashtruesi është vendosur me lejen paraprake të NSH-së dhe në të njëjtën i ka të ndërtuar katër objekte [të tipit P+0] të cilat janë dedikuar për zyre dhe depo.

Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur ekspertizën gjeodezike, duke shpjeguar pretendimet lidhur me kërkesën e tij. Sipas ekspertizës gjeodezike, ne këtë parcelë janë ndërtuar katër objekte dhe te gjitha ne periudhën 1999-2000. Objekti 1 S-428m², Objekti 2 S- 212m², objekti 3 S- 66m² dhe objekti 4 S-6m² dhe sipas palës te gjitha janë te ndërtuara me material te fortë dhe shërbejnë për pune te ndryshme si zyre, depo, frigorifer si dhe shitore.

Parcela kadastrale e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Mitrovicë dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme pasi që gjendet në pjesë relativisht të mirë të Komunës së Mitrovicës. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit ka disa objekte ashtu sikurse janë përshkruar ne ekspertizën gjeodezike dhe hartën tematike, mirëpo te njëjta janë te ndërtuara duke u kombinuar me material të fortë dhe konstruksione metalike dhe të njëjtat nuk krijojnë ndikim me karakter qenësor në përmbajtjen e asetit sipas nenit 4 paragrafi 1.2, të Rregullores për shitjen direkte të asetëve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore. Parcela ka qasje në rrugë përmes parcelës 2896-1 e cila evidentohet ne regjistrin kadastrale së pronë Komunale



Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-211/57

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P. Nr.02897-4 me sipërfaqe të përgjithshme prej 251 m², ZK Mitrovicë, pronë e NSh Miniera "Kosova Azbest" Mitrovicë, me parashtruesin _____, nga Mitrovica.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Miniera "Kosova Azbest" Mitrovicë, me parashtruesin _____ nga Mitrovica.


Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës se tij parcela gjendet në kufi me parcelën në të cilën ushtron aktivitetin e tij biznesor. Parcela sipas palës ka qenë e pashfrytëzuar dhe e mbushur me mbeturina prej ma të ndryshmeve të cilat pas përfundimit të luftës i ka larguar nga aty, dhe të njëjtën e ka rregulluar atë hapësirë dhe e ka bërë të shfrytëzueshme dhe të njëjtën e shfrytëzon prej atëherë të pa penguar nga askush dhe ku është pjesa e oborrit të restorantit. Tutje duke pasur parasysh këto rrethana pala ka shprehur gatishmërinë për ta privatizuar këtë parcelë. Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur ekspertizën gjeodezike, duke shpjeguar pretendimet lidhur me kërkesën e tij. Parcela kadastrale e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Mitrovicë dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme pasi që gjendet në pjesë relativisht të mirë të Komunës së Mitrovicës. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit ka një objekt, mirëpo i njëjti është i ndërtuar me konstruktion metal (Ilastër) dhe është shfrytëzuar për autolarje. Parcela ka qasje në rrugë, mirëpo e njëjta është ne një disnivel, përderisa pjesa tjetër e parcelës 2898-29 ku pala ka te ndërtuar objektin afarist – Restorant është pronë komunale. Përderisa në pjesë veriore dhe veriperëndimore kufizohet me parcelat 2897-1 dhe 2897-6 te cilat evidentohen në emër të NSh-së dhe të njëjtat janë objekt shqyrtimi me propozimin për refuzim. Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/58

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P. Nr.02894-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 155 m² dhe P. Nr.02897-6 me sipërfaqe të përgjithshme prej 521 m², ZK Mitrovicë pronë e NSh Miniera "Kosova Azbest" Mitrovicë, me parashtuesin nga Mitrovica.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Miniera "Kosova Azbest" Mitrovicë, me parashtuesin nga Mitrovica.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij parcelat të cilat janë objekt i kërkesës dëshiron ti blejë përmes shitjes direkte pasi që të njëjtat i shfrytëzon dhe e kanë në posedim që nga viti 2000 dhe se deri më tani nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje me fqinjët për kufijtë që i shfrytëzojnë. Kufijtë e parcelës në shumicën e rasteve janë shenjë truar me rrethoja nga teli, rrethoj druri dhe rrethoj murri. Tutje duke pasur parasysh këto rrethana pala ka shprehur gatishmërinë për ta privatizuar këtë parcelë. Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur ekspertizën gjeodezike, duke shpjeguar pretendimet lidhur me kërkesën e tij. Parcelat kadastrale të cilat janë objekt i kërkesës gjenden në ZK Mitrovicë në Komunën e Mitrovicës dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme pasi që gjendet në pjesë relativisht të mirë të Komunës së Mitrovicës. Në kufijtë të tyre gjendet parcela tjetër e NSh-se në të cilën zhvillohet aktivitet biznesor. Në këto parcela aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit ka një objekt me karakter të përkohshëm, i njëjti është i ndërtuar me konstruksion metali (llastër) dhe është shfrytëzuar depo magazinim të gjerave të familjes po ashtu ka edhe një serë. Parcelat kanë qasje në rrugë, mirëpo të dy këto parcela në pjesën ku është qasja në rrugë janë të rrethuara me muri dhe se përmes parcelës 02897-6 behet qasja hyrës ku parashtuesi i kërkesës se bashku me familjen e shfrytëzojnë si oborr. Në kufi me parcelën 2894-1 gjenden parcelat private të parashtuesit të kërkesës 2894-2 dhe 2894-3 ku edhe gjendet objekti B+P+4 të cilin e ka ndërtuar pala me familjen e vetë. Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/59

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të 3871 m² nga ngastra kadastrale P. Nr.464-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 11697010 m², ZK Sërbicë e Epërme, pronë e NSh KBI Progres, Prizren, me parashtruesin nga Prizreni.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, Prizren, me parashtruesin nga Prizreni.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij parcela gjendet në shfrytëzim nga pala qysh nga viti 1962 dhe të njëjta shfrytëzohen për nevoja bujqësore nga pala.

Në mbështetje të kërkesës pala ka prezantuar edhe ekspertizën gjeodezike duke treguar matjet lidhur me pretendimet e tij. Sipas saj, pjesa e parcelës e cila është objekt i kërkesës kufizohet me parcelën 476-1 e cila evidentohet në emër të palës

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike dhe të cilat janë marrë nga ZK Prizren parcela 461-1 ZK Sërbicë e Epërme evidentohet si parcelë tokësore e klasit të gjashtë dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndërtim, dhe po ashtu të njëjta ka një sipërfaqe relativisht të madhe prej 11 ha dhe e njëjta ka qasje të pa penguar në rrugë. Rruga publike e cila shtrihet përbrenda parcelës në fjalë.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/60

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale nr. 00169-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 7800 m², ZK Dushanovë, pronë e NSh KBI Progres, Prizren, me parashtruesin nga Prizreni.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, Prizren, me parashtruesin nga Prizreni.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij parcela është në afërsi me parcelën në të cilën ushtron veprimtari biznesi, servis për automjete, dhe se me blerjen e parcelës shtese do ta zgjeroj veprimtarinë.

Në mbështetje të kërkesës pala ka prezantuar edhe disa fotografi nga terreni dhe aerofotografi lidhur me pretendimet e tij.

Sipas të dhënave të prezantuara në kërkesë dhe pamjes nga gjeoportali parcela 00169-0 shtrihet në ZK Dushanovë evidentohet si parcelë vakante dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme. Në këtë parcelë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndërtim, dhe po ashtu e njëjta ka qasje të pa penguar në rrugë.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/61

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale nr. 730-4 e sipërfaqe të përgjithshme prej 3066 m², ZK Lubizhdë, pronë e NSH KBI Progres, Prizren, me parashtruesin nga Prizreni.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSH KBI Progres, Prizren, me parashtruesin nga Prizreni.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës se tij parcela njëjta është në afërsi me parcelën në emër të gjyshit të tij, në të cilën ushtron veprimtari biznesi dhe se me blerjen e parcelës shtesë do ta zgjeroj veprimtarinë.

Në mbështetje të kërkesës pala ka prezantuar edhe disa fotografi nga terreni dhe aerofotografi lidhur me pretendimet e tij.

Sipas të dhënave të prezantuara në kërkesë dhe të cilat janë marrë nga ZKK në Prizren parcela 00730-4 ZK Lubizhdë evidentohet si parcelë tokë jo pjellore në vendin e quajtur Slogovi-Kod Java dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme. Në këtë parcelë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndërtim dhe parcela rrethohet nga pronarë të ndryshëm duke përfshirë edhe NSH-në.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të paraqtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/62

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale nr. 00987-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4685 m², ZK Lubizhdë, pronë e NSh KBI Progres, Prizren, me parashtruesin nga Prizreni.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, Prizren, me parashtruesin nga Prizreni.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij parcela njëjta është në afërsi me parcelën në emër të gjyshit të tij, në të cilën ushtron veprimtari biznesi dhe se me blerjen e parcelës shtese do ta zgjeroj veprimtarinë. Në mbështetje të kërkesës pala ka prezantuar edhe disa fotografi nga terreni dhe aerofotografi lidhur me pretendimet e tij.

Sipas të dhënave të prezantuara në kërkesë dhe të cilat janë marrë nga ZKK në Prizren parcela 00987-1 1 ZK Lubizhdë evidentohet si parcelë tokësore jo pjellore në vendin e quajtur Slogovi dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme. Në këtë parcelë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndërtim.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/63

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale 450 m² nga ngastra kadastrale P. Nr.00917-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2658 m², ZK Matiqan, Prishtinë, pronë e NSh KBI "Kosova Export" – Ratar, me parashtruesen nga Prishtina.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI "Kosova Export" – Ratar, me parashtruesen nga Prishtina.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës se saj është theksuar se pala këtë parcele e ka blerë në vitin 1997 me çmim prej 12,000 marka gjermane nga dhe të njëjtën e ka në shfrytëzim që nga ai vit dhe duke mos u kontestuar nga askush që nga ajo kohë. Pala ka theksuar se pjesën e parcelën ne fjale e ka të rrethuar me gardh rrethues dhe në të ka të mbjella pemë. Pala nuk ka dhënë ndonjë argument mbështetës me dokumente të cilat do ta vërtetonin pretendimin e saj për blerjen e kësaj prone.

Ne anën tjetër me datën 05.02.2024 pala ka dërguar një Urgjencë për trajtimin e kërkesës se saj për shitjes direkte duke pasur parasysh gjendjen e saj shëndetësore si shkak i Diabetit.

Në mbështetje të kërkesës pala ka prezantuar edhe ekspertizën gjeodezike duke treguar matjet lidhur me pretendimet e saj.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike pjesa e parcelës 00917-1 e cila është objekt i kërkesës në Veri është e kufizuar me parcelën 917-3 pronë private e dhe me posedues , ne pjesën jugore te saj është e kufizuar me parcelën 917-2 prone private në emër te në pjesën perëndimore është e kufizuar me parcelën 908-0 me posedues , përderisa në pjesën lindore është parcela në shqyrtim nga e cila kërkohet shkëputja e pjesës e cila është pronë e NSh-së.

Parcela kadastrale e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Matiqan - Prishtinë. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndërtim, dhe po ashtu e njëjta ka qasje të pa penguar në rrugë e cila është përbrenda parcelës së NSh-se dhe për dalje në rrugë kadastrale.



Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-211/64

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes prej 32025 m² pjesë e ngastres kadastrale P. Nr.01767-1 me sipërfaqe të përgjithshme 47400 m², ZK Obiliq, pronë e NSh KBI Kosova Export – NSh Bujqësia, Fushë Kosovë, me parashtruesin nga fshati Shkabaj Obiliq.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Export – NSh Bujqësia, Fushë Kosovë, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij përmes procesit të privatizimit ka blerë tokë bujqësore prej 288HA. Përveç parcelave në pronësi të palës që ndodhen në ZK Prishtinë, Orlovic, Mazgit dhe Obiliq, disa parcela të palës si ato me nr.1767-73; 1767-74; 1767-77; 1767-78; 1766-1 në ZK Obiliq, janë parcela që kufizohen me parcelën 1767-1 ZK Obiliq dhe e cila është objekt i kërkesës për privatizim përmes shitjes direkte.

Tutje, pala ka theksuar se duke pasur parasysh, projekte e tyre zhvillimore, kjo parcelë është bërë pengesë për realizimin e projekteve zhvillimore të kompanisë. Sipas palës kjo parcelë ka rendësi të veçantë për vazhdimin e projektit inventiv andaj edhe ka kërkuar blerjen e kësaj pjese të parcelës përmes shitjes direkte.

Duhet theksuar se nga sipërfaqja e tërësishme prej 47400 m² kësaj parcele i janë shpronësuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për ndërtimin e rrugës magjistrale Prishtine – Mitrovicë rreth 15094 m².

Pala në mbështetje të kërkesës, ka bashkangjitur edhe ekspertizën gjeodezike duke elaboruar pretendimet dhe shpjegimet përkatëse lidhur me kërkesën. Tutje, në ekspertizë është theksuar se kjo parcelë në pjesën dërmuese të saj është e kufizuar me prona private të kompanisë në fjalë. Parcela kadastrale e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Obiliq në Komunën e Obiliqit dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit ka ndërtim, dhe e njëjta e ka një sipërfaqe relativisht të madhe prej 32025 m² e cila është objekt i kërkesës. Sa i përket qasjes në rrugë në njërin pjesë është e kufizuar me auto udhën ashtu sikurse është shpjeguar në ekspertizë si dhe në pjesën verilindore të saj kufizohet me parcelën e rrjedhës së Ibër Lepencit.



Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-211/65

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes prej 572 m² pjesë e ngastres kadastrale P. Nr.1052-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 8602 m², ZK Piranë, pronë e NSh Prizren Coop, me parashtruesin nga fshati Piranë Prizren.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Prizren Coop, me parashtruesin nga fshati Piranë Prizren.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala në kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij të njëjtat janë në shfrytëzim përmbi 30 vite se bashku me anëtarët e familjes së tij dhe të njëjtën edhe mbajnë në shfrytëzim dhe të njëjtën e ka të rrethuar me gardhë të gjallë ku verës e shfrytëzon si park për fëmijë, ndërsa në sezonin vjeshtor dhe dimëror për sistemimin e gjerave verore si dhe e njëjta është në funksion të stallës. Në mbështetje të kërkesës pala ka prezantuar edhe ekspertizën gjeodezike duke treguar matjet lidhur me pretendimet e tij.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike dhe të cilat janë marrë nga ZKK në Prizren parcela 1052-1 ZK Piranë evidentohet si parcelë tokësore e klasit të katërtë në vendin e quajtur Raishte dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndërtim, dhe po ashtu të njëjta kanë qasje të pa penguar në rrugë

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/66

Pasi që ka kuptuar se ka të bëjë me pronë shoqërore që administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka shprehur gatishmëri që ta privatizon pjesën e parcelave kadastrale në sipërfaqe të përgjithshme prej 631 m². Duke ju referuar fakteve dhe rrethanave të përshkruara si më lartë dhe duke i analizuar objektivisht ato, konstatojmë se:

- është jo kontestuese se punëtoria është ndërtuar pas vitit 2002;
- objekti ka karakter të afatgjatë;
- është i dedikuar për ushtrimin e veprimtarisë zejtare;
- pala ka ndërtuar mbi bazë e akteve të nxjerra nga Komuna e Skenderajt pa qenë në dijeni se prona është pronë shoqërore dhe administrohet nga AKP.;



- ushtron veprimtarin e automekanikut nga e cila edhe mbanë familjen.

Parashtruesi i kërkesës ka pretendim për blerje e sipërfaqeve të caktuara nga dy parcela kadastrale dhe atë 02495-0 dhe 02496-0, gjithsej 631 m². Është fakt se pala ka të ndërtuar objektin në tokën e NSh-së, i cili ka destinim komercial e jo të banimit. Gjatë vizitës në teren lokali ishte i mbyllur dhe sipas informatave në terren nuk kishte aktivitet tash e një kohë të gjatë.

Është evidente se pala ka hy në posedim me pëlqimin e Komunës së Skenderajt dhe ka ndërtuar objektin e që shikuar nga një aspekt bie në kategorinë siç ka përcaktuar nenin 3.1.1

DSHD ka analizuar rastin së bashku me provat e paraqitura nga pala dhe ato të siguruar nga vetë divizioni, është realizuar vizita në teren dhe është konstatuar se kërkesa e palës nuk i plotëson të gjitha kushtet ligjore për kategorinë e asetit specifik në kuptim të nenin 3 paragrafi 1.1 ose 1.2 të Rregullores nr 16/2023.

NSh-ja është pronare e tri parcelave kadastrale të cilat sipas gjendje faktike dhe kadastrale kufizohen njëra me tjetrën dhe kanë shtrirje horizontale ndërsa sipas kërkesës së palëve ekspertiza gjeodezike është përgatitur në atë formë sipas të cilës është bërë ri konfigurimi i parcelave si dhe zgjerimi i kërkesave apo pretendimeve të tyre për sipërfaqe më të madhe se që fillimisht e kishte lejuar komuna. Prandaj palët për interes të tyre, kanë bërë tejkalimin e pëlqimit të Komunës, dhe se propozimet apo kërkesat e tyre janë përtej kërkesave racionale dhe kushteve ligjore apo frymës së Rregullores për shitje direkte si shkas për përjashtimin e tenderit publik. Prandaj, gjatë analizimit të rastit duke krahasuar dispozitën ligjore sidomos paragrafin e fundit të nenit 3.1.1, wshtw konstatuar se pavarësisht faktit se ekziston objekti nuk është gjendje e pa kthyeshme në gjendjen paraprake të tokës para ndërtimit të objektit dhe se mundësit reale për vlerë më të madhe të asetit janë në tenderin publik

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/77

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes prej 155 m² pjesë e parcelës kadastrale 02495-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1740 m², dhe të sipërfaqes prej 41 m² pjesë e parcelës kadastrale 02496-0, me sipërfaqe të përgjithshme 1066 m² - të cilat gjinden në ZK Bajë Komuna e Skenderajt, pronë e N.Sh. "Produkt" Skenderaj, me parashtruesin nga fshati Leqinë Komuna Skenderaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh "Produkt" Skenderaj, me parashtruesin nga fshati Leqinë Komuna Skenderaj

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se palës përmes shkresës zyrtare me nr. 8561/2015 me datën 03.07.2015 iu është kërkuar që të praqes dokumente në bazë të cilave e shfrytëzon parcelën kadastrale me nr. 2496-0 dhe 2495-0 mbi të cilën ka ndërtua objektin, punëtorinë për kryerjen e veprimtarisë zejtare. është përgjigjur me shkresën me nr. 1821/2015 me datën 25.08.2015 me të cilën shpreh gatishmërinë që lidhur me objektin – punëtorin zejtare të ndërtuar në parcelat kadastrale është i gatshëm që marrëdhëniet pronësore-juridike ti rregulloj me negociim të drejtpërdrejt nga Komisioni për ndërtime ilegale.

deklaron se ai kishte hyrë në posedim të pronës së NSh-së dhe kishte ndërtuar mbi bazën e Kontratës mbi shfrytëzimin e përkohshëm të pjesës së parcelave kadastrale të lidhur me Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të KK. Së Skenderajt, të datës 30.04.2002 për të cilin edhe kishte dhënë Aktvendimin mbi lejin e shfrytëzimit të pjesës së ngastrës kadastrale të leshura nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK. Së Skenderajt me nr. 353-50/2002

Në bazë të akteve të tilla juridike edhe ka ndërtuar punëtorin dhe ka shfrytëzuar pjesën e parcelave kadastrale dhe ka paguar qiranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të KK. Së Skenderajt.

Pala kur ka kuptuar se bëhet fjalë për pronën Shoqërore që administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka shprehur gatishmëri që ta privatizon pjesën e parcelave kadastrale në sipërfaqe të caktuara në të cilat ka ndërtuar dhe i ka në posedim. Duke ju referuar fakteve dhe rrethanave të përshkruara si më lartë dhe duke i analizuar objektivisht ato, konstatojmë se:

- është jo kontestuese se punëtoria është ndërtuar pas vitit 2002;
- objekti ka karakter të afatgjatë;
- është i dedikuar për ushtrimin e veprimtarisë zejtare;



- pala ka ndërtuar mbi bazë e akteve të nxjerra nga Komuna e Skenderajt pa qenë në dijeni se pronë është pronë shoqërore dhe administrohet nga AKP.

Është fakt se pala ka të ndërtuar objektin në tokën e NSh-së, i cili ka destinim komercial e jo të banimit. Gjatë vizitës në teren lokali ishte i mbyllur dhe sipas informatave në terren nuk kishte aktivitet tash e një kohë të gjatë.

Rregullorja për Shtitje Direkte Nr. 04/2024, në nenin 4 ka përcaktuar kategoritë e aseteve specifike. Është evidente se pala ka hy në posedim me pëlqimin e Komunës së Skenderajt dhe ka ndërtuar objektin e që shikuar nga një aspekt bie në kategorinë siç ka përcaktuar neni 3.1.1. DSHD ka analizuar rastin së bashku me provat e paraqitura nga pala dhe ato të siguruara nga vetë divizioni, është realizuar vizita në teren dhe është konstatuar se kërkesa e palës nuk i plotëson të gjitha kushtet ligjore për kategorinë e asetit specifik në kuptim të nenin 3 paragrafi 1.1 ose 1.2 të Rregullores nr 16/2023.

NSh-ja është pronare e tri parcelave kadastrale të cilat sipas gjendje faktike dhe kadastrale kufizohen njëra me tjetrën dhe kanë shtrirje horizontale ndërsa sipas kërkesës së palëve ekspertiza gjeodezike është përgatitur në atë formë sipas të cilës është bërë ri konfigurimi i parcelave si dhe zgjerimi i kërkesave apo pretendimeve të tyre për sipërfaqe më të madhe se që fillimisht e kishte lejuar komuna. Prandaj palët për interes të tyre, kanë bërë tejkalimin e pëlqimit të Komunës, dhe se propozimet apo kërkesat e tyre janë përtej kërkesave racionale dhe kushteve ligjore apo frymës së Rregullores për shitje direkte si shkas për përjashtimin e tenderit publik. Prandaj, gjatë analizimit të rastit duke krahasuar dispozitën ligjore sidomos paragrafin e fundit të nenit 3.1.1, është konstatuar se pavarësisht faktit se ekziston objekti nuk është gjendje e pa kthyeshme në gjendjen paraprake të tokës para ndërtimit të objektit dhe se mundësit reale për vlerë më të madhe të asetit janë në tenderin publik.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/78

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes prej 1490 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 198-0, me sipërfaqe të përafshme 12298 m², ZK Ferizaj për pronën e NSh Pasuria Bujqesore Ferizaj me parashtruesin nga Ferizaji.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Pasuria Bujqesore Ferizaj me parashtruesin nga Ferizaji.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se gjatë shqyrtimit të kërkesave të parashtruesve të lidhur me parcelën kadastrale 00198, nga informatat në teren kemi kuptuar se pala aktualisht ka në posedim sipërfaqen prej 490 m², në të cilën nuk gjendet ndonjë objekt i ndërtuar në të. Në shkresat e lëndës ekziston një ekspertizë gjeodezike e cila përshkruan gjendjen faktike sipas të cilës ekziston një ndërtim-shtëpi dhe ka një sipërfaqe prej 1409 m². Ekspertiza është bërë në vitin 2015 dhe nuk e identifikon personin se kush është në posedim. Nga vizita e realizuar në teren nga stafi i DSHD-së, janë mbledhur informata rreth identifikimit të palës e cila është në posedim dhe sipas po këtyre informatave thuhet se posedues është

Rasti në fjalë është specifik për faktin se të gjitha të dhënat tregojnë se deri në vitin 2018, ka ekzistuar ndërtimi mirëpo në ditën e vizitës së asetit dt 16 shtator 2024, në këtë pjesë të parcelës nuk ka ndërtime. Pala është i pa qasshëm dhe nuk kemi arrit ta kuptojmë se si ka hyrë në posedim të kësaj pjese të pronës, mbi cilën bazë - marrëveshje paraprake apo kontratë të shitblerjes dhe cilat janë pretendimet e tij konkretisht.

DSHD nuk ka disponuar me asnjë shkresë apo dokumentacion dorëzuar nga pala, mirëpo është krahasuar raporti i vizitës, dokumentet dhe informatat e siguruara sipas detyrës zyrtare, gjendja faktike në teren nga ku është jo kontestuese se prona është në posedim të palës nuk shfrytëzohet për banim dhe nuk ka ndërtuar objektin e banimit apo objekt tjetër.

Në pronë nuk ka të ndërtuar shtëpi banimi, prona është e rrethuar me themele betoni nuk shfrytëzohet për qëllime banimi apo komerciale, ka qasje direkte në rrugë. Parcela nr. 00198-0, shtrihet buzë rrugës publike nga ana jugore dhe perëndimore, në anën lindore kufizohet me Shkollë ndërsa në anën veriore me prona private.

MAH



Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/79

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore 964 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 292-0, me sipërfaqe të përgjithshme 10085 m², pronë e NSh KB "Talinovci" Ferizaj, me parashtruesin nga fshati Talinoc i Jerlive Ferizaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KB "Talinovci" Ferizaj, me parashtruesin nga fshati Talinoc i Jerlive Ferizaj.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve të dorëzuara nga pala, janë krahasuar edhe me raportin e vizitës në teren dhe konstatohet se në sipërfaqen e kërkuar nuk ekziston ndonjë objekti i banimit dhe nuk përputhet me të dhënat në ekspertizën gjeodezike dhe gjendjes faktike në teren. Në pronë nuk ka të ndërtuar shtëpi banimi, prona shfrytëzohet për oborr dhe rrugë kalimi për në pronën private të parashtruesit. Parashtruesi i kërkesës është prona i parcelës kadastrale Nr 297-2 në të cilën ka të ndërtuar shtëpinë e banimit ndërsa pjesa e pronës që kërkohet nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt por shfrytëzohet si oborr dhe pjesë kalimi në përmes parcelës e NSh-së në pronën e tij private ku edhe jeton.

Nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/80

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 277 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 292-0, me sipërfaqe të përgjithshme 10085 m², pronë e KB "Talinovci" Ferizaj, me parashtruesin nga fshati Talinoc i Jerlive Ferizaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KB "Talinovci" Ferizaj, me parashtruesin nga fshati Talinoc i Jerlive Ferizaj.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve të dorëzuara nga pala, janë krahasuar edhe me raportin e vizitës në teren dhe konstatohet se në sipërfaqen e kërkuar nuk ekziston ndonjë objekti i banimit dhe nuk përputhet me të dhënat në ekspertizën gjeodezike dhe gjendjes faktike në teren. Në pronë nuk ka të ndërtuar shtëpi banimi dhe nuk specifikohet se për çka shfrytëzohet prona.

Bordi konstatoi se në parcelë nuk ka ndërtim andaj nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/81

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 377 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 292-0, me sipërfaqe të përgjithshme 10085 m², pronë e KB "Talinovci" Ferizaj, me parashtruesin **aga fshati Talinoc i Jerlive Ferizaj**.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të caktuar në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KB "Talinovci" Ferizaj, me parashtruesin **aga fshati Talinoc i Jerlive Ferizaj**.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve të dorëzuara nga pala, janë krahasuar edhe me raportin e vizitës në teren dhe konstatohet se në sipërfaqen e kërkuar nuk ekziston ndonjë objekt i banimit dhe nuk përputhet me të dhënat në ekspertizën gjeodezike dhe gjendjes faktike në teren. Në pronë nuk ka të ndërtuar shtëpi banimi, prona shfrytëzohet për oborr dhe rrugë kalimi për në pronën private të parashtruesit. Parashtruesi i kërkesës është pronar i parcelës kadastrale Nr 1028-2 në të cilën ka të ndërtuara shtëpitë e banimit ndërsa pjesa e pronës që kërkohet nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt por shfrytëzohet si oborr dhe pjesë kalimi në përmes parcelës e NSh-së në pronën e tij private ku edhe jeton.


Bordi konstatoi se në parcelë nuk ka ndërtim andaj nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/82

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1056 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 292-0, me sipërfaqe të përgjithshme 10085 m², pronë e KB "Talinovci" Ferizaj, me parashtruesen nga fshati Talinoc i Jerlive Ferizaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KB "Talinovci" Ferizaj, me parashtruesen nga fshati Talinoc i Jerlive Ferizaj.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve të dorëzuara nga pala, janë krahasuar edhe me raportin e vizitës në teren dhe konstatohet se në sipërfaqen e kërkuar nuk ekziston ndonjë objekti i banimit dhe nuk përputhet me të dhënat në ekspertizën gjeodezike dhe gjendjes faktike në teren. Në pronë nuk ka të ndërtuar shtëpi banimi, prona shfrytëzohet për oborr dhe rrugë kalimi për në pronën private të parashtrueses. Prona e cila kërkohet nuk ka të ndërtuar ndonjë objekt por shfrytëzohet si oborr dhe pjesë kalimi në përmes parcelës e NSh-së në pronat tjera private për palët e treta.

Bordi konstatoi se në parcelë nuk ka ndërtim andaj nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/83

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 492 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 292-0, me sipërfaqe të përgjithshme 10085 m², pronë e KB "Talinovci" Ferizaj, me parashtruesin nga fshati Talinoc i Jerlive, Ferizaj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KB "Talinovci" Ferizaj, me parashtruesin nga fshati Talinoc i Jerlive Ferizaj.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ne kërkesën e vet e ka bazuar vetëm ne faktin se sipas deklaratës se tij se ai ka në posedim sipërfaqen prej 492 m², dhe se e mbanë këtë hapësirë të tokës pa e penguar e as kontestuar nga askush. Kërkesa e palës është dorëzuar përmes postës elektronike nga Inxhinier i gjeodezisë i cili ka përgatit edhe ekspertizën gjeodezike. Ekspertiza thekson se pala është në posedim të shtëpisë me oborr por nuk tregon që ka ndërtim të shtëpisë e as ndonjë foto nga vendi i ngjarje nga ku mund të shihet shtëpia e banimit.

Bordi në bazë të dëshmive të ofruara nga DSHD-ja konstatoi se në parcelë nuk ka shtëpi banimi por një objekt përcjellës dhe se është i mundur kthimi i pronës në gjendjen e mëparshme. Andaj bazuar në këtë që u cekë më lart Bordi shqyrtoi rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/84

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Nenit 10.1.4 të Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, Nenit 3.13.1 të Rregullores Nr. 8/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të NSH-ve, Neneve 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprobimet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte respektivisht për qiradhënie direkte të ngastrës kadastrale P-70713080-0212K-0 ZK Ujz me sipërfaqe totale prej 14 ha 23 ari 1 m² pronë e NSH KB Rogova për parashtruesin e kërkesës Alban Gashi, përfaqësues i Restaurant “Permaja” sipas përcaktimit të çmimit të qirasë në shumën prej 1,537.00 €/vit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për transferin e kontratave të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Më datë 06.09.2024 është pranuar kërkesa nga ana e Alban Gashi përfaqësues i Restaurant Permaja për qiramarrjen e ngastrës kadastrale P-70713080-0212K-0 ZK Ujz me sipërfaqe totale prej 14 ha 23 ari 1 m² (142301 m²) me kulturë arë e klasës 2, 3 dhe 4. Komisioni i formuar në bazë të vendimit DM 411-2024 të Drejtorit Ekzekutiv për përgatitjen e raportit të vlerësimit për qiranë, bazuar në informatat e siguruara, hulumtimet e bëra dhe vizitën e pronës, ka konstatuar se bazuar në gjendjen faktike në terren çmimi që duhet të përcaktohet për ngastrën kadastrale P-70713080-0212K-0 ZK Ujz me sipërfaqe totale prej 14 ha 23 ari 1 m² është në shumën prej 1,537.00 Euro për një vit kalendarik.

Sipas vlerësimit të AL-së, aprovimi i qirasë direkte do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të sigurt të hyrave vjetore, duke mundësuar kështu rritjen e ndjeshëm të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore dhe për më tepër këto fonde do të përdoren për nevoja të NSH-së apo do të mbahen në mirëbesim për t’u ndarë kreditorëve meqë Ndërmarrja është në likuidim dhe përfundimisht Buxhetit të Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë dhe/apo jo i drejtpërdrejtë nga inkasimi i të hyrave nga qiratë pasi të kryhen pagesat për shpenzimet e likuidimit dhe pagesat për kreditorët. Për më tepër, pala e arsyeton kërkesën e tij mbi bazën që qiramarrja e këtij aseti do të rrit mirëqenien ekonomike dhe do të zgjerojë biznesin e tij, duke i mundësuar poashtu që të angazhojë numër shtesë të punëtorëve. Kërkesa ka letër mbështetëse nga Kryetari i Komunës së Gjakovës dhe nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – për të zhvilluar agroturizmin dhe turizmin në këtë komunë. Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 15 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/85

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve, sipas nenit 2.9.1 të kontratës bazë të qirasë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me 15 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e qiramarrësit Ventius International, ku i lejohet bashkëpunimi me operatorët tjerë të cilët planifikojnë të hyjnë në partneritet, përkitazi me asetin "Conex" për të cilin ka kontratë qiraje me NSH Jatex, me kushtin e ndryshimit të lartësisë së qirasë me një kontratë të unifikuar dhe atë në lartësinë prej 11,356.57 euro/muaj.
- II. Në rast që gjatë adaptimit të objekteve vie deri tek ndonjë dëmtim i objekteve, qiramarrësi obligohet që me shpenzime të veta të bëjë menjherë kthimin në gjendjen e mëparshme.
- III. Qiramarrësi Ventius International obligohet që të dorëzoj në AKP polisën e sigurimit të objektit
- IV. Qiramarrësi Ventius International obligohet që në emër të investimeve që pritet të bëhen në objekt të dorëzoj në AKP garancion në ndërtim me mbulueshmëri në vlerë mbi 1,000,000 € dhe pas funksionalizimit të objektit të dorëzoj garancionin e sigurimit të objektit me mbulueshmëri së paku 3,000,000 € ku përfitues primar është NSH Jatex, Gjakovë.
- V. Polisa e sigurimit të objektit duhet të ripërtrihet në baza vjetore dhe të i dërgohet si dëshmi qiradhënësit.
- VI. Qiramarrësi Ventius International obligohet që para se të filloj çfarëdo ndryshime në pronën subjekt i kontratës paraprakisht të merr pëlqim nga Drejtoritë relevante në Komunën e Gjakovës.
- VII. Qiramarrësi Ventius International obligohet që ta dorëzoj në AKP pëlqimin të cilin e ka marr nga Drejtoritë relevante në Komunën e Gjakovës për adaptim të objektit, si dhe 6 muaj pas datës së pëlqimit do të aplikohet qiraja e rivlerësuar.
- VIII. Nëse rimodeilimi/ adaptimi i objektit ndodh para afatit prej 6 muajve atëherë pagesa e qirasë së rivlerësuar do të filloj të aplikohet nga data e përfundimit të objektit;
- IX. Çfarëdo ndryshime apo shtesa nga Qiramarrësi në Lokalet Afariste për të cilat është marrë pëlqimi paraprak nga AKP-ja dhe të cilat nuk mund të hiqen pa shkaktuar dëmtim në Lokalet Afariste, pas përfundimit të kësaj Kontrate të Qirasë nuk do të kompensohen në çfarëdo mënyre nga Qiradhënësi, AKP-ja apo çfarëdo pale e tretë tek e cila mund të transferohet qiraja në përputhje me klauzolën 2.9 të kësaj Kontrate të Qirasë ose sipas veprimit të ligjit.
- X. Aprovimi i kërkesës nuk nënkupton edhe të drejtën e blerjes me shitjes direkte.
- XI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e kërkesës sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Me datë 23 gusht 2024 është paraqitur në mbledhjen Bordit kërkesa e qiramarrësit Ventius Internacional lidhur me kërkesë për dhënien e pëlqimit ku i njëjti cek që kërkesa e tyre ka për qëllim zhvillimin e aktivitetit në operimin e një modeli "multi purpose", ku gërshetohet sektori i prodhimit dhe atij të shitjes me pakicë, që ka për qëllim që prodhimet që janë të destinuara për treg të brendshëm të ju ofrohen konsumatorëve në të



njëtin lokacion. Gjithashtu në shkresë ceket që nevojiten edhe aktivitete shtesë, siç janë shërbime të ushqimit dhe pijeve, shitje të prodheteve të specializuara teknologjike, tekstili etj dhe për realizimin e këtij projekti është i deomoshëm bashkëpunimi me partner lokal të cilët do të veprojnë në hapësirat e përbashkëta, si rrjedhojë qiramarrësi me qëllim që të jetë konform me kushtet e kontratës paraqet këtë kërkesë për të marrë pëlqimin në fjalë nga AKP-ja.

Në shkresë e datës 16 korrik 2024 qiramarrësi cek që garanton që prona me qira nuk do të pësojë ndryshime të pa riparueshme strukturale, dhe çfarëdo mdryshimi apo investimi do të jetë i tipit i cili mund të zhbëhet varësisht nga statusi final, apo projektet zhvillimore që potencialisht mund të ketë AKP, dhe me kërkesë të AKP-së brenda afateve optimale mund të kthehet në gjendjen e mëparshme, si dhe që janë të gatshëm që të garantojnë këtë përmes garancionit bankar.

Lidhur me kërkesën e qiramarrësit në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht 2024 Bordi ka shtyrë vendimarrjen dhe ka udhëzuar Menaxhmentin që sigurojë projektin e qiramarrësit, sa i përket hapësirës ajo të përcaktohet qartë në bazë të projektit të bëhet edhe llogaritja e qirasë dhe të paraqitet çmimi për aprovim."

Bazuar në pikën e lartcekur është formuar komision mbi për hulumtimin/vlerësimin e çmimit të tregut në lidhje me kërkesën e Operatorit Ekonomik Ventius International për modifikimin e hapësirës të cilën e ka në shfrytëzim sipas kontratës se qirasë me NSH Jatex Gjakove. Që të përcaktohet qartë lidhur me projektin se qfarë planifikohet të bëhet nga ana e qiramarrësit, me datë 18 shtator 2024 anëtarët e komisionit së bashku me përfaqësuesin e qiramarrësit Ventius International kanë realizuar vizitën në terren për sqarim lidhur me projektin ideor që mendojnë ta implementojnë në hapësirat që i shfrytëzojnë me qira në NSH Jatex. Gjatë vizites së realizuar nga anëtarët e komisionit, ju është prezantuar verbalisht projekti ideor për shtimin e një hapësire, ku po ashtu këtë projekt e kanë dorëzuar me email me datë 23/09/2024. Pjesa e cila parashikohet të bëhet shtimi i hapësirës me material te përkohshëm në skicë është emëruar si Aneksi A-06, ndërsa sa i përket hapësirave tjera nga informatat e dërguara parashihet hapja e dy lokaleve Comodita dhe Prince Coffe House (Hapësira këto te cilat do te modifikohen vetem brenda kufijve ekzekutues pa dalje te jashtme).

Andaj meqenëse hapësirat e tjera janë veçse të dhëna me qira dhe rivlerësimi i aseteve është bërë më 2023, vlerësimi dhe llogaritja e tokës është bërë në bazë të projektit të dorëzuar konkretisht për shtojcën e Aneksit A-06 me sipërfaqe prej 1,019.10 m², e cila parashihet të vendoset në pronën e NSH-së, si objekt i përkohshëm. Raport ky i paraqitur në mbledhjen e Bordit të drejtorëve të datës 30.09.2024. Si rrjedhojë Bordi në këtë ka udhëzuar menaxhmentin përmes pikave të veprimi, konkretisht me pikën 8.2 e dalur nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të datës 30 shtator 2024, ku është udhëzuar menaxhmenti i AKP-së që të analizoje rastet e ngjashme si kjo dhe në mbledhjen e muajit tetor 2024 të vijë me propozim, po ashtu është kërkuar që prona e dhënë me qira të trajtohet në aspektin komercial pasi që si e tillë edhe është duke u shfrytëzuar dhe të trajtohet komplet aseti i dhënë me qira, duke përfshirë oborrin dhe hapësirën tjetër që i është dhënë me qira.

Pas analizës së bërë e cila tregon se kërkesa për modifikim të hapësirës nga Ventius është në përputhje me çmimet tregu dhe praktikën e aplikueshme për objekte të ngjashme.

Duke e analizuar këtë situatë, mund të konkludohet se kërkesa e Ventius sh.p.k për modifikimin e hapësirës është e arsyeshme dhe e justifikuar në bazë të praktikave të ngjashme tregu. Kjo do të sigurojë një trajtim të barabartë dhe transparent, si dhe do të kontribuojë në rritjen e aktivitetit ekonomik në këtë sektor.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 15 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/86

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Ligjit nr. 08/L-111 Për Arkivat, 05 Shtator 2022.

Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 15 tetor 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Menaxhmentit dhe aprovohen shpenzimet për bartjen e dokumentacionit të NSh-ve në likuidim në arkivat përkatëse në vlerën prej 35,000 euro për paketat për transportim, vendosjen e kutive të arkivit në paketa, paletat, si dhe foljen e najlonit për lidhjen e paketave për transport.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për shqyrtimin dhe miratimin e shpenzimeve për bartjen e dokumentacionit të NSh-ve në likuidim në arkivat përkatëse.

Ky vendim është aprovuar duke pasqyruar faktin se Projekti për Rregullimin e lëndës arkivore të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim dhe transferimin në arkivat kompetente ka përfunduar në rajonin e Prizrenit, Pejës, Mitrovicës dhe Prishtinës, ndërsa dokumentacioni i rajonit të Gjilanit, për shkak të zhvendosjes në Prishtinë, është ende duke u rregulluar nga OSh-të e rajonit të Prishtinës, ku, pas rregullimit, do të kthehet prapë në Gjilan, konkretisht në Arkivin kompetent në Gjilan. Në mënyrë që të transferohet në arkivat kompetente, është kërkuar miratimi i shpenzimeve për bartjen e dokumentacionit të NSh-ve në likuidim në arkivat përkatëse.

Bordi po ashtu ka pasqyruar faktin se janë përfunduar punët e Projektit në rajonin e Prizrenit, Pejës, Mitrovicës dhe Prishtinës, ndërsa dokumentacioni i rajonit të Gjilanit, për shkak të zhvendosjes në Prishtinë, është ende duke u rregulluar nga OSh-të e rajonit të Prishtinës. Mirëpo, supozohet që sasia e dokumentacionit që do të transferohet në arkivin kompetent do të jetë e përafërt me sasinë e dokumentacionit të rajonit të Prishtinës. Deri më 31.12.2024, do të përfundojë dhe më pas do të kthehet prapë në Gjilan, në arkivin përkatës. Me këtë rast, AKP do të përfitojë nga lirimi i qirave të depove të arkivave të NSh-ve në likuidim të rajoneve të AKP-së, të cilat të gjitha së bashku, për gjashtë muaj, kapin vlerën totale prej 67,155 euro. Sasia e dokumentacionit të rregulluar i të gjitha depove të arkivave të NSh-ve në likuidim të rajoneve të AKP-së, është rreth 66,000 kuti arkivi të rregulluara për transfer në arkivin kompetent. Andaj, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të përafërt të kostos së transferimit të dokumentacionit nga arkivat rajonale në arkivin përkatës, jemi bazuar në kostot e zhvendosjes së arkivit të rajonit të Gjilanit në deponë e rajonit të Prishtinës në Hajvali. Kostoja e kësaj zhvendosjeje ka qenë 6,485 euro, e cila nuk përfshin vendosjen e kutive të arkivit në paketa për transport, pasi këtë punë e kanë kryer OSh-të e angazhuara në Projektin për Rregullimin e lëndës arkivore të NSh-ve në likuidim për rajonin e Gjilanit. Si rezultat, është paraparë një vlerë prej 35,000 euro për paketat për transportim, vendosjen e kutive të arkivit në paketa, paletat, si dhe foljen e najlonit për lidhjen e paketave për transport.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
Prishtinë, më 15 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-211/87

Në bazë të nenit 15.2.1 dhe 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Neni 15, paragrafët 2 dhe 3 i Statutit të Bordit të AKP-së, dhe Neni 10 i Ligjit Nr. 06/L-081 për qasje në dokumente publike, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 15 tetor 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bordi i Drejtorëve aprovon kërkesën nga pala avokat Mehdi Geci për qasje në pjesën e procesverbalit ku shqyrtohet pika 7.5 nga mbledhja e Bordit e mbajtur me datën 25 maj 2017.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Divizionit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit lidhur me kërkesën e palës avokat Mehdi Geci për qasje në procesverbal të Bordit më konkretisht për pjesën kur është diskutuar për çështjen e NSh Përparimi – Dajti në mbledhjen e datës 25 maj 2017 lidhur me Vendimin Nr. Ref. BD-92/12.

Ky vendim është aprovuar duke pas parasysh faktin se gjatë diskutimeve të mëparshme të Bordit është kërkuar që të ndryshohen Metodat e përlogaritjes së çmimit orientues. Andaj për këtë qëllim me datë 24 shtator DE përmes vendimit të evidentuar si 416b-2024 ka themeluar Komisionin për amandamentimin e Procedurave të Shitjes përmes tenderit publik.

Sipas Statutit të Bordit diskutimet në Bord janë konfidenciale dhe mund të bëhen publike vetëm me autorizim të Bordit, Drejtorit individual, apo autoriteteve kompetente ligjore. Kërkesa është bërë nga pala duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për zyrtar publik, konsiderojmë se si kërkesë i plotëson të gjitha kushtet të trajtohet si kërkesë e tillë.

Është analizuar Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në dokumente publike, i cili në nenin 10 parasheh formën se si paraqiten Kërkesat për qasje në dokumente publike

Sipas nenit 15, paragrafi 2 i Statutit të Bordit, diskutimet në Bord duke përfshirë dhe votimin janë veprime konfidenciale të Bordit të Drejtorëve dhe se ato mund të behen publike vetëm me autorizim të Bordit, dhe konsiderojmë se qasja lejohet vetëm pasi që Bordi të trajton kërkesën dhe të vlerëson arsyeshmëri dhe bazën juridike të kësaj kërkesë në raport me Statutin dhe Ligjin për qasje në dokumente publike. Ligji për qasje në dokumente publike e konsideron publik çdo dokument që prodhohet në një institucion publik, dhe u jep të drejta të gjera publikut për qasje në këto dokumente.

Ndërsa sipas nenit 15, paragrafi 3 i Statutit të Bordit, thuhet se në bazë të kërkesës së një pale të interesuar, të bërë sipas procedurës së përcaktuar me ligj, Bordi mund t'ia përcjellë kësaj pale kopjen e versionit të përmbledhur të procesverbalit të përshkruar në nenin 6, paragrafi 4 të Statutit.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 15 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit